

		ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Njsela:		Nr. Prot.:	
Unit:	KO	Prot. No.:	50/2020
Jednica:		Br. Prot.:	
Nr. i faqev:		Data:	17.07.2020
No. of pages:	-02-	Datum:	
Br. stranica:			
Prishtinë			



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. I REF. 50/2020

KËSHILLI DREJTUES I OMK-SË, në mbështetje të Nenit 21, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 dhe 1.13 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Neni 31 paragrafi 1 me nënparagrafët 1.1 dhe 1.14 si dhe Nenin 32, paragrafin 1 të Statutit të OMK-së dhe Nenit 24 dhe 25 të Rregullores për Punën e Këshillit Drejtues të OMK-së, në mbledhjen e rregullt të datës 17 korrik 2020, miraton këtë:

V E N D I M

- I. BASHKOHEN në procedurë unike administrative të gjitha kërkesat individuale për valorizimin e pikëve akredituese për Edukim të Vazhdueshëm Profesional me procedurën administrative të rilicencimit.
- II. Aplikuesit për rilicencim të udhëzohen që të parashtrojnë aplikacionin për valorizim të pikëve akredituese paralelisht me aplikacionin për rilicencim. Procedura e vlerësimit do të zhvillohet paraprakisht në Komisionin për EVP, dhe pas konstatimit të përmbushjes së pikëve të valorizuara, aplikacioni për rilicencim së bashku me shkresat e lëndës për valorizimin e pikëve të EVP-së dërgohen për vendosje në Komisionin për Licencim.
- III. Të gjithë aplikuesit sipas këtij Vendimi, me rastin e parashtrimit të aplikacionit për valorizim të pikëve akredituese të EVP-së dhe atë të rilicencimit, duhet të paguajnë fillimisht taksën në vlerë prej 10.00 (dhjetë) € (euro), ndërkaq diferencën e taksës për rilicencim do tu kërkohej që ta paguajnë me rastin e rëheqjes së aktit të rilicencimit.
- IV. URDHËROHET Shërbimi Profesional, përkatësisht Asistentja Administrative pranë Zyres për Anëtarësim dhe Licencim që palët t'i udhëzojë për aplikim paralel të valorizimit të pikëve të EVP-së dhe rilicencim.
- V. Vendimi është i zbatueshëm deri në plotësim/ndryshimin dhe aprovimin në mbledhjen e rradhës të Kuvendit të OMK-së, të Rregullores për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional dhe

Rregullores për Regjistrim, Licencim dhe Rilicencim të Mjekëve për procedurat e aplikimit për rilicencim pranë OMK-së.

VI. Vendimi hyn në fuqi me 1 gusht 2020.

KËSHILLI DREJTUES I OMK-SË
NR. I REF. 50/2020 dt.17 korrik 2020

Prishtinë, 17 korrik 2020

Kryetar i Këshillit Drejtues të OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.Scj

